



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 6821
Data: 22.08.2025

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR NË HAN TË ELEZIT I HAPUR PËR TË
GJITHË QYTETARËT PËR DRAFT BUXHETIN PËR VITIN 2026 DHE
PARASHIKIMET PËR VITET 2027-2028**

Procesverbali nga Dëgjimi i parë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028, të mbajtur me datën **08.08.2025**, duke filluar nga ora **10:00** në **Sallën e Takimeve**, në objektin e Komunës së Hanit të Elezit që gjendet në katin e I-rë, me gjithsej 12 pjesëmarrës/e, prej tyre 5 gra dhe 7 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Nënkryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Sevdi Dernjani**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**, si dhe nga Zyra e Kryetarit dhe disa nga drejtorët/et e drejtorive.

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës **z.Sevdi Dernjani**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve, të cilët kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2026, si dhe parashikimi për vitet 2027-2028, ku për rend të punës, kishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**
2. **Diskutimi**

Sevdi Dernjani thekson: Jemi në fazën e dëgjimeve buxhetore publike për projektet që ne i kemi paraqitur, për t'i parë edhe ju se çka kemi në projeksionet buxhetore tona për këto vite dhe t'i marrim idetë dhe propozimet tuaja sipas kërkesave dhe nevojave tuaja që i keni. Edhe pse pjesëmarrja është e vogël sot, gjithsesi kisha kërkuar nga ju që të jepni idetë dhe propozimet tuaja. Do të doja të falënderoj edhe Donjetën nga DEMOS. Si një hyrje e prezantimit të draft buxhetit, ku buxheti i komunës për vitin 2026 është 4.2 milion €, si dhe burimet e financimit të Komunës së Hanit të Elezit janë: Granti i Përgjithshëm, Granti specifik i arsimit, Granti specifik i shëndetësisë dhe Të Hyrat Vetanake. Për prezantim më të detajuar, do të ia japim fjalën drejtoreshës për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor, në veçanti Donjeta Morinën e cila ka ndihmuar shumë në procesin e planifikimit buxhetor, si në KAB gjithashtu edhe tash në draft buxhet).

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti në disponim për vitin 2026 është 4,234,682 €, prej tyre e dedikuar për investime kapitale është shuma 891,140 €, pra këtë shumë ne mund ta shpenzojmë për projekte të ndryshme kapitale, ku para vetes keni fletushkat e përgatitura nga Instituti GAP, të cilën janë të listuara projektet kapitale, ku ka projekte që barten vit pas viti, por edhe projekte tjera të propozuara nga qytetarët. Nëse keni ndonjë propozim, ne jemi të hapur për t'i dëgjuar dhe më pas këto do të dërgohen për diskutim dhe shqyrtim me grupin punues për hartimin e draft buxhetit.

2. Diskutimi

Sevdi Dernjani: Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit. Nëse keni ndonjë sugjerim, rekomandim, kërkesë për buxhetin e vitit 2026.

Amir Dernjani: Kisha propozu me u fut në projekt buxhet projekti për rregullimin e përrockave në fsh. Paldenicë, sepse gjatë dimrit dhe të reshurave, ka vërshime dhe po del uji jashtë. Në Paldenicë, janë dy përrocka: një te Ramuktë dhe një te Krasniqt.

Hisni Luri: E kam një propozim prej një qytetari që ka si shqetësim kundërmimi i erës pranë hyrjes së Sharrcemit, është një përrockë e hapur aty dhe mirë me u mbulu ajo.

Remzi Bushi: Kisha propozu që te rr.Imer Vila në fshatin Paldenicë, një rrugë diku me gjatësi 170-180 metra me e ndërtu kanalizimin atmosferik dhe asfaltimin e asaj rruge për shkak se janë dëmtu kubëzat e asaj rruge. Poashtu te varrezat e Lagjes Bushi të Epërm me e ndërtu rrugën diku me gjatë 300 metra.

Bujar Bushi: Shqetësim i kemi qentë endacakë.

Sevdi Dernjani: Edhe në mbledhjen e fundit të KKS-së si dhe me kryetarin e Komitetit për Komunitete e kemi diskutu çështjen e qenve endacakë, ku ne si nivel komunal jemi shumë të kufizim nga ligji për trajtimin e kësaj çështje, plus asaj ka edhe një kosto shumë të lartë, gjë që ne si Komunë e kemi të pamundur. Ne kemi pas diskutime edhe me komunat tjera, ku komunat e regjionit 05 dhe 06 me e kriju një qendër të përbashkët, po hala nuk kemi diçka konkrete.

Bujamin Berisha: Në fushën e arsimit, a është planifiku rregullimi i nxemjes në sallën e sportit në fshatin Paldenicë.

Hisni Luri: Kjo e rregullimit të nxemjes nuk hyn te investimet kapitale, por tek mallrat dhe shërbimet, kushton diku ma pak se 5 mijë €, e kemi në plan me e rregullu.

Bujanin Berisha: Përfundimi i vitit shkollor po na nxen gati në korrik, me procedura të dëftesave, suksesit, etj, dhe po bëhet tepër nxehtë brenda ambienteve shkollore. A do të ishte e mundur që me u vendos nëpër klasa ka një klimë e vogël, në Paldenicë janë 8 klasa, besoj se ajo ishte shfrytëzu edhe për kohën e dimrit, tash s'po di sa është kostoja buxhetore.

Sevdi Dernjani: Ne do t'i marrim të gjitha rekomandimet tuaja, do t'i shënojmë dhe do t'i shqyrtojmë. A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 10:20.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi

